URDHËR
Nr. 87, datë 16.1.2015

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 27 dhe 29 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar dhe të shkronjës "a", të pikës 1, të kreut V, të vendimit nr. 1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e prokurimit publik", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, zëvendësministrit të Mbrojtjes, z. Petro Koçi, për procedurat e prokurimeve me vlerë të vogël.
2. Ngarkohen zëvendësministrat e Mbrojtjes dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij urdhri.
3. Urdhri nr. 359, datë 28.3.2014 i ministrit të Mbrojtjes "Për delegim kompetencash" të titullarit të autoritetit kontraktor zëvendës-ministrit të Mbrojtjes, z. Dritan Hila, revokohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MBROJTJES
Mimi Kodheli